



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 568/1 Prot.

Shkodër, më 09.09.2023

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 64, datë 28.08.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, pika 1, shkronja “b”, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, shtojca 1, pika 13/2, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 22, shkronja “F”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 5254 prot., datë 04.09.2023 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.08.2023”, shqyrtoi VKB nr. 64, datë 28.08.2023 “Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.236 km, për linjat elektrike gjatesore të tensionit të lartë, ngastra nr. 93 dhe 94, ekonomia pyjore Gjadër Mnele”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI I BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 64 datë 28.08.2023

**“Dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 1.236 km “për linjat elektrike gjatësore të tensionit të lartë në ekonomine Pyjore Gjader Mnele”.**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkitimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë votash.këshilli bashkiak:**

V E N D O S I

- 1.Dhënien në përdorim të sipërfaqes prej **1.236 km “për linjat elektrike gjatësore të tensionit të lartë”**, në ngastrat **nr.93.94.** të ekonomisë pyjore **Gjader Mnele .**
- 2.Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet.
- 3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”
- 4.Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
- 5.Ngarkohen Drejtoria e pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- 6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Kryetari Këshillit  
Ervis Shimaj

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Ardian Çelepija

Miratuar me 18 vota  
Vota Pro 18  
Vota Kunder -  
Vota Abstenim -  
Zbardhur me datë 01.09.2023